








RR 647 840 809 AA

Referuar permbajtjes te nenit 511 te K.Pr.Civile te ndryshuar me ligjin nr.38/2017, ne te cilin parashikohet shprehimisht se : "*Titulli ekzekutiv vihet ne ekzekutim nepermjet leshimit te urdherit te ekzekutimit i cili : a) per rastet e parashikuara nga shkronja "a" dhe "b" te nenit 510 te ketij Kodi leshohet nga gjykata qe ka dhene vendimin ne dispozitivin e vendimit*", por dhe ndodhur ne kushtet kur ky vendim civil permban detyrime midis paleve, gjykata eshte e detyruar te leshoje urdherin e ekzekutimit ne dispozitiv te vendimit, i cili behet i ekzekutueshem nga Zyra Permbarimore me marrjen e tij forme te prere.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenin 132 te K.Familjes dhe nenet 126 dhe 306-310 te K.Pr.Civile

V E N D O S I

Zgjidhjen e marteses ligjore te lidhur midis bashkeshorteve Marie Çezma dhe Petro Agolli ne dt.05.01.2005.

Lenien e femijes te mitur Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 per rritje dhe edukim nenes se saj Marie Çezma duke i njohur atit te saj Petro Agolli te drejten per te patur takime me te dy here ne muaj, te shtunen e dyte dhe te katert te cdo muaji nga ora 14.00` deri ne oren 17.00` te se njejtes dite;

Detyrimin e te paditurit Petro Agolli te paguaje ne favor te femijes Stefania Agolli e dtl.13.03.2006 si detyrim per ushqim, shumen prej 10.000 (dhjetemije) leke cdo muaj, per periudhen nga dita e paraqitjes te kerkesepadise 31.10.2022 deri ne dt.13.03.2024;

Detyrimin e te paditurit Petro Agolli te paguaje ne favor te femijes Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 si detyrim per ushqim, shumen prej 10.000 (dhjetemije) leke cdo muaj, detyrim i cili fillon nga dita e paraqitjes te kerkesepadise 31.10.2022;

Urdherohet kryesekretaria qe brenda 15 diteve nga dita qe ky vendim merr forme te prere te dergoje nje kopje te tij ne Zyren e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq per regjistrim.

Shpenzimet gjyqesore prej 33.260 (tridhjete e tremije e dyqind e gjashtedhjete) leke te parapaguara nga pala paditese lihen ne ngarkim te dy paleve ne masen 50 % sejcili.

Leshimin e urdherit te ekzekutimit te ketij vendimi me marrjen e tij forme te prere, referuar nenit 511 te K.Pr.Civile te ndryshuar.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, Tirane, brenda 15 diteve nga dita e neserme e njoftimit te vendimit te arsyetuar te tij.

U shpall ne Korce, sot ne dt.03.04.2024

SEKRETARE
Onada HAJDINI

GJYQTARE
Eglantina MIKANI

vazhdueshëm me te, por gjate intervistimit me psikologen eshte shprehur se do te respektonte vullnetin e femijes sa here qe ajo te deshironte, qendrimin e vete femijes e cila shprehet e gatshme per te takuar atin e saj cmohet qe e drejta e takimit te femijes prej te padituri te caktohet ne menyren e rekomanduar nga psikologia. Ne keto kushte, Gjykata disponon per lenien e femijes te mitur Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 per rritje dhe edukim nenes te saj Marie Çezma duke i njohur atit te saj Petro Agolli te drejten per te patur takime me te dy here ne muaj, te shtunen e dyte dhe te katert te cdo muaji nga ora 14.00` deri ne oren 17.00` te se njejtes dite.

Se fundi, ne caktimin e kesaj te drejte takimi, gjykata mban parasysh rrethanat konkrete ne te cilat ndodhet aktualisht kjo lloj marredhenie ne momentin e shqyrtimit te padise dhe se ajo eshte e ndryshueshme ne vijim mbi kerkesen e seciles pale duke u kushtezuar kjo nga ndryshimi i rrethanave apo marredhenies te vendosur midis te padituri dhe femijes.

Si pasoje e zgjidhjes se marteses, ***Gjykata ka detyrimin te caktoje edhe kontributin per detyrim ushqimor*** qe i padituri duhet te japе ne favor te femijes te tij te mitur, pasi rregullimi i pasojave qe vijne per shkak te zgjidhjes se marteses eshte detyrim qe gjykata duhet ta permbushe edhe kryesisht pavaresisht nga kerkimet e paleve ndergjyqese. Gjykata duke patur parasysh rrethanat e sipercituara lidhur me gjendjen ekonomike te seciles pale, ku paditesja deklaron se ka nje pune ku eshte e vetsiguruar, ndersa per te padituri ai deklaroi se trajtohet me ndihme nga shteti grek ne masen 200 euro, por pa mundur te vertetoje nje rrethane te tille, moshen e femijeve e nevojat e tyre ne rritje, deklarimet e dhena ne séance nga pala paditese lidhur me masen e kontributit ushqimor, cmon se, i padituri duhet te kontribuoje ne procesin e rritjes se femijeve dhe plotesimin e nevojave jetesore te tyre me nje pension ushqimor ne masen 10.000 (dhjetemije) leke cdo muaj per sejcilen. Persa i perket femijes Stefania Agolli e dtl.13.03.2006 patur parasysh momentin kur ajo ka mbushur moshen madhore pra 18 vjec (gjate gjykimit te ceshtjes) cmohet se lind detyrimi i te padituri te paguaje si detyrim per ushqim, shumen prej 10.000 (dhjetemije) leke cdo muaj, per periudhen nga dita e paraqitjes te kerkesepadise 31.10.2022 deri ne dt.13.03.2024. Ndersa ne lidhje me femijen Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 cmohet se i padituri detyrohet te paguaje si detyrim per ushqim, shumen prej 10.000 (dhjetemije) leke cdo muaj, detyrim i cili fillon nga dita e paraqitjes te kerkesepadise 31.10.2022.

Ne kushtet kur paditesja me lidhjen e marteses ligjore nuk ka ndryshuar mbiemrin, nje rrethane e tille nuk paraqitet si pasoje per tu rregulluar me zgjidhjes e saj.

Nderkohe ne aplikim te nenit 143 te Kodit te Familjes dhe te nenit 31 te ligjit nr.10129 dt.11.05.2009 "Per Gjendjen Civile", i ndryshuar Gjykata ka detyrimin qe brenda 15 diteve nga dita qe vendimi merr forme te prere te dergoje per regjistrim nje kopje te tij ne Zyren e Gjendjes Civile perkatese, ne rastin ne gjykim ne Zyren e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, si zyra ku jane te regjistruar palet.

Persa i perket shpenzimeve gjyqesore ato rezultuan ne total ne masen 33.260 leke dhe perbehen nga tarifa mbi aktet ne masen 3.000 leke, ajo per shperblimin e psikologes ne masen prej 30.000 leke dhe 260 leke per njoftimin e paleve, te gjitha te parapaguar nga pala paditese. Pavarasisht se gjykata ne themel u shpreh per pranimin e padise, nisur nga objekti i gjykimit ne baze te se ciles secila pale realizon te drejta personale, kur gjykata ne rastin konkret nuk kishte per objekt dhe nuk u shpreh per fajesine pasi nje rrethane e tille nuk u kerkua edhe nga vete palet, nga gjykata cmohet qe keto shpenzime te lihen ne ngarkim lihen ne ngarkim te dy paleve ne masen 50 % sejcili.

pershtatshem per rritje dhe edukim te femijes Natalia Agolli, eshte nena e saj, Maria Cezma. Arsyet e dhenies se ketij mendimi jane:
1. Natalia dhe nena e saj ne asnje moment nuk jane ndare fizikisht nga njera-tjetra.
2. Lidhja fizike, emocionale dhe psikologjike e Natalias me nenen eshte shume e forte dhe cilesore.
3. Nena ka aftesi shume te mira prinderuese dhe stil te shendetshem te prinderimi, stilin autoritativ.
4. Tek nena nuk ka asnje element ne karakterin, sjelljen dhe shendetin e saj mendor qe te mos lejojne kujdesin ndaj vajzes.
5. Nena i siguron banese, ushqim, veshje, shkollim dhe siguri.
6. Ka punesim te rregullt, ben jete familjare te rregullt dhe nuk ka varesi ndaj alkoolit, drograve apo lojrave te fatit.
7. Mendimi i shprehur qarte nga Natalia dhe e argumentuar bindshem eshte qe te jete me nenen e saj, pavaresish se kjo gje ka 9 vite qe eshte fakt.
8. Lidhja e babait me vajzen eshte e dobet emocionalisht dhe ka takime vetem rastesore mes tyre. Gjithashtu dyshimi mbi te qenit ose jo vajza e tij biologjike ka sjelle nje shkeputje emocionale te vajzes me babain.
.....Petro dhe Maria jetojne ne te njejtin qytet, ne Athine, jo shume larg njeri-tjetrit. Natalia aktualisht shihet ne rruge me babain e saj, flasin por nuk realizojne takime te planifikuara dhe te qellimshme. Duke analizuar dhe marredhenien mes tyre, sygjeroj si takime te planifikuara mes tyre, 2 here ne muaj, te shtunen e dyte dhe te katert, 3 ore. Duke marre ne konsiderate edhe moshen e Natalias, 17 vjec, nuk mendoj qe babai te kete te drejte takimi me mbajtje, duke besuar qe nuk do realizohen... » etj.

Per sa me lart, gjykata konkludon se, ne funksion te kushteve sociale dhe ekonomike ne te cilen ndodhen te dy prinderit, vullnetin e vet paleve ndergjyqese (*te shprehur ne séance*), kujdesin e treguar dhe marredhenien e vendosur nga secili prej tyre ndaj fëmijës, perceptimin prindëror të secilit prej tyre për fëmijën, moshen e femijes, stilin aktual të jetesës që fëmija ka krijuar deri ne kete moment duke jetuar me nenen e saj, lidhjen e fortë qe ajo paraqet me paditesen pra nenen e saj duke e perceptuar ate si mbeshtetjen kryesore, por edhe rrethanat e tjera te cilat lidhen me pershtatshmerine e te mitures, e se fundi kjo edhe ne funksion te interesit me te larte te femijes, cmohet qe e mitura Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 duhet ti lihet per rritje dhe edukim nenes te saj Marie Çezma. Ndersa ati i saj, i padituri Petro Agolli te kete te drejten te mbikqyre mbajtjen dhe edukimin e femijes si dhe te informohet e te konsultohet per zgjidhjet e rendesishme qe lidhen me jeten e saj.

Gjykata cmon gjithashtu se, per te ruajtur lidhjen afektive me atin, pra te padituri pasi figura e te dy prinderve eshte mjaft e domosdoshme per mirerritjen e femijes, ai ka te drejten e takimit me te. Ne lidhje me oraret e takimeve psikologia ne relacionin e vleresimit dt.03.04.2024 rekomandoi :
"*...Duke analizuar dhe marredhenien mes tyre, sygjeroj si takime te planifikuara mes tyre, 2 here ne muaj, te shtunen e dyte dhe te katert, 3 ore. Duke marre ne konsiderate edhe moshen e Natalias, 17 vjec , nuk mendoj qe babai te kete te drejte takimi me mbajtje, duke besuar qe nuk do realizohen....* ", rekomandim te cilit ajo i eshte permbajtur me pas edhe ne séance gjyqesore gjate diskutimit te rrethanave konkrete.

Bazuar ne kete rekomandim si dhe ne rrethanat e rezultuara gjate gjykimit, interesimit qe paraqesin te dy palet por dhe lidhjen qe secili prej tyre ka mbajtur me femijen dhe anasjelltas, moshen e femijes dhe reagimin e saj ndaj te dy paleve (prinderve), sikurse dhe marredheniet e ftohta edhe mes vete paleve, faktin qe i padituri muajt e fundit nuk ka mbanjtur komunikim të

nderprerja e jeteses se perbashket midis bashkeshorteve, te cilet jetojne te ndare faktikisht prej me teper se 3 vjetesh, rrethane kjo e cila ka cuar ne humbjen e qellimit te marteses, ne funksion te mireqenies emocionale dhe materiale dhe mbeshtetjes qe bashkeshortet duhet t'i japin njeri-tjetrit.

Nderkohe qe gjate gjykimit nuk rezultoi e provuar ndonje rrethane se nga zgjidhja e kesaj martese do te kishte pasoja vecanerisht te renda morale dhe materiale per femijet ose bashkeshortin tjeter, per me teper qe nje rrethane e tille edhe nese pretendohej, ajo duhej te provohej sipas percaktimit te dispozites te sipercituar nga vete i padituri.

Nga pohimet e paleve paditese (*te pranuara ne gjykim si prove konform nenit 281 te K.Pr.Civile*) provohet se mosmarreveshjet e vazhdueshme midis padites dhe te padituri kane sjelle si pasoje prishjen e harmonise familjare qe duhet te karakterizoje nje marredhenie martesore normale. Jetesa e perbashket eshte bere e pamundur dhe kjo provohet edhe me faktin se ndarja mes ciftit eshte nje gjendje faktike te pakten prej 8 vjetesh. Ne rastin ne gjykim, Gjykata cmon se jemi ne kushtet e ketij neni, ku mungesa e komunikimit mes paleve, e mosgjetjes te nje zgjidhje te perbashket apo edhe interesimit nga ana e te padituri per paditesen e per femijet i ka cuar ata ne nje gjendje ndarje faktike duke mos i ofruar bashkeshortit tjeter mbeshtetje emocionale (neni 50/2 i K.Familjes), situate kjo qe sipas pohimit te paleves nuk mund te rikuperohet. Per kete shkak Gjykata cmon se duhet te vendose ***zgjidhjen e marteses ligjore midis padites Marie Çezma dhe te padituri Petro Agolli.***

Ne lidhje me pasojat e zgjidhjes se marteses gjykata ka detyrimin te shprehet per pasojat midis bashkeshorteve dhe per pasojat qe kjo zgjidhje do te sjelle per femijen e mitur Natalia Agolli e dtl.01.02.2007. Ne lidhje me femijen e mitur Natalia Agolli, rezulton se, pas vecimit faktik te paleve, ajo ka vijuar te jetoje me nenen e saj, paditesen Marie Çezma. Aktualisht e mitura Natalia Agolli frekuenton klasen e 2 te Liceut Profesional Athine ne shtetin grek, per vitin shkollor 2023-2024, referuar vertetimit nr.76 prot date 29.01.2024. Me zgjidhjen e marteses ligjore, prej pales paditese u kerkua qe femija Natalia Agolli ti lihet asaj per rritje edukim, te caktohet nje pension ushqimor per femijen, ndersa per menyren e takimit te te padituri me femijen te lejohet sipas percaktimit te dhene nga psikologia.

Referuar nenit 6 dhe 155 te K.Familjes gjykata i ka kerkuar padites te paraqiste femijen e mitur ne seance gjyqesore me qellim marrjen edhe te pelqimit te saj se kujt nga prinderit duhej ti besohej ushtrimi i drejteperdrejte i pergjegjesise prinderore pas zgjidhjes te marteses ligjore midis tyre, por nga pala paditese eshte deklaruar se eshte ne pamundesi paraqitje te femijes se mitur.

Per te vendosur mbi ***menyren e ushtrimit te pergjegjesise prinderor***e ne aplikim te nenit 157 te Kodit te Familjes, Gjykata mban parasysh:
-a) qendrimin e vete paleve ndergjyqese, ku paditesja eshte shprehur se kerkon qe femija ti lihet asaj per rritje dhe edukim, ndersa i padituri ka shprehur dakortesine gjate intervistimit me psikologen ppor dhe ne seance gjyqesore qe femija ti lihet padites per rritje dhe edukim ;
-b) mendimin e psikologes te thirrur nga gjykata ne permbushje te detyrimit ligjor qe buron nga neni 155 i Kodit te Familjes. Ne akt vleresimin psikologjik dt.03.04.2024 ajo shprehet se :"... *Bazuar vleresimit te paleve ndergjyqese dhe femijes, sygjeroj gjykaten qe ne momentin qe ndodhen palet dhe femija, bazuar edhe gjithe ecurise se jetes se tyre familjare, prindi me i*

shfaqur grindje dhe mosmarreveshje te theksuara, kjo per shkak te konsumimit te pijeve alkoolike prej te padituri, bixhozit, mungeses se komunikimit e pershtatjes me njeri-tjetrin, rrethana keto te cilat kane ndikuar ne mosfunksionimin e lidhjes martesore. Per shkak te situates te krijuar ne familje, paditesja prej tete vitesh jeton se bashku me vajzat dhe i padituri jeton vecmas. Aktualisht palet kane shkeputur marredhenien me njeri-tjetrin per nje periudhe prej me teper se tete vjet (shtator 2015) dhe gjate kesaj kohe vecimi, nuk kane bere asnje perpjekje per pajtim. Me pretendimin se, kjo martesë e ka humbur qëllimin për të cilin është lidhur dhe ka ngelur thjesht formale, paditesja i eshte drejtuar Gjykates me padine objekt gjykimi.

E pyetur ne séance gjyqesore lidhur me shkakun i cili ka passjelle edhe tronditjen e marredhenies bashkeshortore, ***paditesja Marie Çezma***, ka pretenduar nder te tjera se, i padituri Petro Agolli filloi te mos i perkushtohej me familjes. Sipas paditeses, ne vitin 2006 i padituri filloi te mos punonte, pasi ai konsumonte alkool dhe luante ne lojrat e fatit dhe bastet sportive duke harxhuar te ardhurat e familjes. Ajo u shpreh se punonte ku te gjente mundesi per te mbajtur familjen. Duke vleresuar se per shkak te mungesës te mirekuptimit, te perkujdesit, kontributit e interesimit qe duhet te kishte treguar i padituri ndaj paditeses e familjes, martesa ka humbur kuptimin e saj, duke ngelur vetem nje veprim formal, paditesja kerkon zgjidhjen e marteses ligjore nga i padituri dhe te pasojave te rrjedhura prej saj.

Ndersa nga i ***padituri Petro Agolli prezent*** ne seance gjyqesore u pretendua se paditesja ka kerkuar urdher mbrojtje ndaj tij per te mos ju afruar baneses ne nje largesi prej 20 m dhe ai ka respektuar kete urdherim duke u vecuar prej vitit 2015. I padituri u shpreh se femijet i ka ndihmuar pasi kane qene afer me banim. Ne lidhje me kerkimin per zgjidhjen e marteses ligjore ai u shpreh dakort, ndersa persa i perket pasojave te rrjedhura nga zgjidhja e saj ai u shpreh se eshte dakort qe femijet te qendrojne me nenen e tyre, sikurse edhe persa i perket mases te detyrimit ushqimor, duke u shprehur se aktualisht eshte i papune dhe trajtohet me ndihme nga shteti grek ne masen 200 euro.

Por pavaresisht sa me siper, gjykata nuk e cmoi te nevojshme te hetoje dhe provoje shkakun konkret te kesaj situate konfliktuale, por pasojen qe ajo ka passjell, ne rastin konkret prishjen e harmonise familjare. Per me teper qe, gjykates nuk i duhet te shprehet per fajesine pasi nga te dy palet nuk u paraqit nje kerkim i tille.

Ne analize te rrethanave te sipercituara, te pretendimeve por dhe pohimeve te paleve te dhena ne séance gjyqesore por dhe percaktimit te :
- Nenit 129 e vijues te K.Familjes ku parashikohet se : *"Secili nga bashkeshortet mund te kerkoje zgjidhjen e marteses per shkak te nderprerjes se jeteses se perbashket, kur bashkeshortet jetojne te ndare faktikisht qe prej 3 vjetesh….."*
- Nenit 130 i K.Familjes ne te cilin parashikohet shprehimisht se : "*Gjykata mund te rrezoje padine per shkak te nderprerjes se jeteses se perbashket, kur bashkeshorti tjeter provon se zgjidhja e marteses do te kete pasoja vecanerisht te renda morale dhe materiale per femijet ose bashkeshortin tjeter. Padia mund te ringrihet per te njejtat shkaqe nese ekzistojne rrethana te reja.*"
- Neni 131 i K.Familjes sipas te cilit : " *Nderprerja e jeteses se perbashket mund te paraqitet si shkak per zgjidhjen e marteses vetem nga bashkeshorti qe ka paraqitur kerkesepadine. Bashkeshorti i paditur ka te drejte te paraqese kunderpadi. Ne kete rast, gjykata mund te rrezoje padine dhe te pranoje kunderpadine, duke zgjidhur martesen.*"
dispozita keto ku dhe bazohet kerkesepadia per shqyrtim, nga kjo Gjykate konkludohet se, ne rastin ne gjykim provohet ekzistenca e kushtit te kerkuar nga nenit 129 te K.Familjes :

Gjykata, pasi degjoi shpjegimet e paleve ndergjyqese ne gjykim, shqyrtoi provat shkresore, raportin psikologjik dhe analizoi ne teresi rrethanat e ceshtjes

V E R E N

Me kerkesepadi te depozituar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Korce (*e cila aktualisht mban emertimin Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korce*) paditesja Marie Çezma duke thirrur si te paditur bashkeshortin e saj Petro Agolli ka kerkuar "*Zgjidhjen e marteses ligjore*" duke e bazuar ate ne nenin 129 e vijues te K.Familjes te titulluar "*Zgjidhja e marteses ligjore per shkak te vecimit faktik*". Nderkohe qe ne permbajtje te kerkesepadise paditesja parashtron edhe kerkime te tjera te cilat lidhen me pasojat e rrjedhura prej zgjidhjes te kesaj martese ligjore e konkretisht persa i perket lenies te femijes per rritje dhe edukim, caktimin e nje pensioni ushqimor, si per te drejten e takimit te prindit tjeter me femijen.

Qe ne fillim te gjykimit nga kjo Gjykate u konstatua kryesisht fakti se bazuar ne nenet 36/1 dhe 59/1 te K.Pr.Civile, gjykimi i kesaj ceshtje i perket juridiksionit gjyqesor dhe se kjo Gjykate, ka kompetencen lendore dhe tokesore per shqyrtimin e saj, konform neneve 41 dhe 51 te K.Pr.Civile, si gjykata e vendit ku bashkeshortet kane pasur banimin e tyre te perbashket te fundit ose ne gjykaten e vendit ku ka banimin i padituri qe ne kete rast eshte e njejta gjykate.

Pas kryerjes se veprimeve te pajtimit, te zhvilluara ne seancen e veprimeve pergatitore te dt.16.01.2024, ne prani vetem te paditeses te paraqitur personalisht, nderkohe qe per te paditurin gjykimi ka vijuar ne mungese referuar nenit 179/3 dhe 133/b te K.Pr.Civile *(duke u kryer njoftimi nepermjet afishimit te shpalljes publike ne kushtet kur ka rezultuar i larguar jashte shtetit, referuar te dhenave te sistemit TIMS dhe vertetimit te Njesise Administrative perkatese*) Gjykata arriti ne perfundimin se pajtimi mes bashkeshorteve dhe rikthimi ne nje vazhdimesi normale te marteses i tyre ishte i pamundur. Per kete arsye, Gjykata vendosi kalimin e ceshtjes per shqyrtim ne séance gjyqesore.

Lidhur me themelin e ketij gjykimi, gjate shqyrtimit gjyqesor, nga pohimet e paleve ndergjyqese (pasi i padituri u paraqit ne seance gjyqesore) dhe nga provat shkresore rezultoi e provuar si me poshte :

Paditesja Marie Çezma dhe i padituri Petro Agolli fillimisht kane bashkejetuar ne shtetin grek ku nga kjo bashkejetese kane lindur dy femijet e pare Anastasia Agolli e dtl.04.06.1993 dhe Kostandina Agolli e dtl.27.06.1997 (aktualisht madhore) ndersa martesa ligjore e tyre eshte lidhur ne dt.05.01.2005 (*provuar me certificate martese leshuar ne dt.27.12.2019 nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq)* dhe nga kjo martesa iu ka lindur dy femije te tjere Stefania Agolli e dtl.13.03.2006 dhe Natalia Agolli e dtl.01.02.2007.

Ka rezultuar e provuar se, palët ndërgjyqëse janë lidhur ne martese me dashuri dhe njohja e tyre ka filluar ne vitin 1991, duke jetuar ne shtetin grek. Gjate bashkejeteses kane ardhur ne jete dy femijet Anastasia Agolli e dtl.04.06.1993 dhe Kostandina Agolli e dtl.27.06.1997. Ne vitin 2005 palet jane kthyer ne Shqiperi per te qendruar nje kohe te shkurter dhe gjate kesaj periudhe qendrimi kane lidhur martesen ligjore ne dt 05.01.2005. Pasi lidhen martesen ligjore pala paditese dhe e paditur se bashku me femijet e tyre u larguan serish ne Greqi duke vazhduar normalisht jeten e tyre bashkeshortore. Nga kjo martese ju kane lindur edhe dy femijet e tjere, Stefania Agolli e dtl.13.03.2006 dhe Natalia Agolli e dtl.01.02.2007. Fillimisht marredheniet midis paleve kane qe ne normale, por me kalimin e kohes jane

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TE JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM
KORÇE

NR. REGJ.THEM. 21001-01633-41-2022 (358/644/1394) **NR.VENDIMI 41-2024-1196(338)**
DT. REGJ.01.11.2022 **DT.VENDIMI 03.04.2024**

V E N D I M
"Ne emer te Republikes"

Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korçe e perbere prej :

Gjyqtare : Eglantina Mikani

Asistuar nga sekretare gjyqesore Onada Hajdini, ne Korce, sot ne dt.03.04.2024, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore te zhvilluar me dyer te hapura ceshtjen civile me nr.regj.them. 21001-01633-41-2022 (358/644/1394) date regj.01.11.2022 qe i perket:

Paditese : Marie Çezma, e bija e Ali dhe Asime, e dtl.10.07.1969, lindur dhe banuese ne Vashtemi, Njeisa Administrative Libonik, Bashkia Maliq, e martuar me kater femije, nga te cilet dy te mitur, perfaqesuar ne gjykim nga av.Arben Shushi nepermjet prokures te posacme me nr.8301 rep. e nr.5783 kol., dt.27.12.2019.

I paditur : Petro Agolli, i biri i Nevrus dhe Haxhike, i dtl.26.08.1968, lindur ne Korce dhe banues ne Maliq, i martuar, me kater femije, nga te cilet dy femije te mitur.

Objekti : Zgjidhje e marteses me te padituri Petro Agolli per shkak te nderprerjes se jetes se perbashket. Lenien e femijeve te mitur Stefania Agolli e dtl.13.03.2006 dhe Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 per rritje dhe edukim paditeses Marie Cezma. Detyrimin e te padituri Petro Agolli te paguaje per femijet e mitur Stefania Agolli e dtl.13.03.2006 dhe Natalia Agolli e dtl.01.02.2007 pension ushqimor ne masen 20.000 lek ne muaj. Te drejten e takimit te te padituri Petro Agolli me femijet e mitur Stefania Agolli dhe Natalia Agolli ne vleresim te gjykates.

Baza ligjore : neni 129 e vijues te K.Familjes.

Ne perfundim te hetimit gjyqesor, te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit te paditeses dhe te padituri, ne pretendimet perfundimtare u kerkua :

Perfaqesuesi i paditeses Marie Cezma, av.Arben Shushi : pranimin e kerkesepadise zgjidhjen e marteses ligjore mes paleve ndergjyqese. Femija Stefania Agolli aktualisht rezulton madhore ndaj kerkon vetem lenien e femijes Natalia Agolli per rritje pales paditese, detyrimin e te padituri te paguaje per femijen Stefania Agolli deri ne dt.13.03.2024 qe nga ngritja e padise shumen 10.000 lek, detyrimin per femijen Natalia Agolli ne shumen 10.000 lek ne muaj qe nga momenti i ngritjes se padise. Te drejten e takimit te femijes Natalia Agolli sipas psikologes. Shpenzimet gjyqesore na ngarkim te paleve 50% per secilen pale.

I padituri Petro Agolli : Dakort me zgjidhjen e marteses ligjore, femija ti lihet per rritje dhe edukim nenes. Lidhur me detyrimin per ushqim eshte dakort me masen e kerkuar nga pala paditese, si dhe me te drejten e takimit te rekomanduar nga psikologia.